

BALFIN SH.P.K

(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)



BALFIN Sh.p.k

**Raporti i audituesit të pavarur
dhe Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Përmbajtja

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA	
GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	4
1. Informacione të përgjithëshme	5
2. Bazat e përgatitjes dhe deklaratës së pajtueshmërisë	5
3. Perdorimi i vleresimeve, supozimeve dhe gjykimeve	6
4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	6
5. Raportimi për hërë të parë sipas snfr	14
6. Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme	17
7. Aktive afatgjata materiale.....	19
8. Aksione dhe pjesëmarrje të tjera.....	20
9. Llogari të tjera të arketueshme.....	21
10. Huadhenie.....	22
11. Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	22
12. Kerkesa të arketueshme	23
13. Parapagime të dhena dhe shpenzime të shtyra	23
14. Investime të mbajtuara me vlerën e drejte përmes fitim/humbjes.....	23
15. Të pagueshme ndaj furnitoreve	23
16. Të pagueshme ndaj punonjesve dhe detyrimet tatimore përkatëse	24
17. Detyrime tatimore	24
18. Huamarrje	24
19. Llogari të tjera të pagueshme	25
20. Të ardhura nga shërbimet.....	25
21. Të ardhura nga dividendet.....	25
22. Të ardhura nga ulja e kapitalit.....	25
23. Të ardhura të tjera	25
24. Shpenzime administrative.....	26
25. Shpenzime të personelit.....	26
26. Të ardhura dhe shpenzimet financiare.....	26
27. Shpenzimet e tatimit fitimit.....	27
28. Administrimi i rrezikut	27
29. Angazhime në qira operative	29
30. Angazhimet dhe detyrimet e kushtezuara	29
31. Palet e lidhura.....	30
32. Ngjarje pas datës së bilancit.....	30

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Balfin sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Balfin sh.p.k (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Balfin sh.p.k paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe flukseve të parasë për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi i BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri ("Kodi IEKA"), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritët që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Balfin sh.p.k përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors
29 maj 2020
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor

BALFIN SH.P.K*(Gjithe vlerat janë shprehur në mijë Lek)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

AKTIVET	Sh.	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017	1 janar 2017
Aktivët Afatgjatë				
Aktive të tjera afatgjatë materiale	7	76,837	47,462	30,070
Aktive të tjera afatgjatë jomateriale		435	580	725
Aksione në njësi të kontrolluara	8	9,818,607	6,091,129	3,895,951
Aksione në njësi me pjesëmarrje JV	8	34,404	58,918	177,494
Aksione në njësi jo të kontrolluara	8	20,029	75,583	92,603
Llogari të tjera të arkëtueshme	9	559,043	670,448	1,058,294
Huadhenie	10	453,347	315,061	1,014,405
Totali i aktiveve afatgjatë		10,962,702	7,259,181	6,269,542
Aktivët Afatshkurtra				
Mjete monetare dhe ekuivalente	11	1,626,555	2,366,136	3,100,743
Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	12	41,208	97,340	66,981
Parapagime të dhena dhe shpenzime të shtyra	13	184,578	20,616	13,014
Investime të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitim/humbjes	8	-	141,913	-
Huadhenie	10	3,680,009	1,214,120	710,723
Totali i aktiveve afatshkurtra		5,532,350	3,840,125	3,891,461
AKTIVET TOTALE		16,495,052	11,099,306	10,161,003
PASIVET				
Kapitali dhe Rezervat				
Kapitali aksionar		3,216,205	3,216,205	3,216,205
Fitimet e pashpërndara		11,671,930	5,404,681	3,907,675
TOTALI I KAPITALIT		14,888,135	8,620,886	7,123,880
Detyrimet afatgjatë				
Huamarrje	18	-	2,362,164	718,338
Totali i detyrimeve afatgjatë		-	2,362,164	718,338
Detyrime afatshkurtra				
Të pagueshme ndaj furnitorëve	15	24,022	33,136	52,393
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe detyrimet tatimore përkatëse	16	12,362	4,485	3,592
Detyrime tatimore	17	79,895	4,149	2,467
Huamarrje	18	899,962	74,486	226,788
Llogari të tjera të pagueshme	19	590,676	-	2,033,544
Totali		1,606,917	116,256	2,318,785
TOTALI I PASIVEVE		1,606,917	2,478,420	3,037,123
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		16,495,052	11,099,306	10,161,003

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA
GJITHPËRFSHIRËSE**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga kontratat me klientët		-	-
Të ardhura nga shërbimet	20	272,645	229,961
Të ardhura nga dividendët	21	5,862,752	1,651,704
Të ardhura nga ulja e kapitalit	22	792,206	-
Të ardhura të tjera	23	10,233	5,012
Totali i të ardhurave		6,937,836	1,886,677
Shpenzime administrative	24	(267,255)	(257,963)
Shpenzime të personelit	25	(282,863)	(152,597)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7	(15,107)	(9,874)
Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit		6,372,611	1,466,243
Të ardhura financiare	26	116,791	55,653
Shpenzime financiare	26	(172,520)	(55,703)
Fitim nga investime të mbajtura për shitje me VFPPH		8,175	30,814
Fitim nga shitja e investimeve		18,496	-
Fitimi para tatimit		6,343,553	1,497,007
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 15%	27	(76,304)	-
Fitimi neto i vitit financiar		6,267,249	1,497,007

Emri/Firma

Edlira Kluka
Administratori

Emri/Firma

Blerina Doka
Drejtori i Finances*Blerina Doka*

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BALFIN SH.P.K*(Gjithë vlerat janë shprehur në mijë Lek)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL**

	Kapitali aksionar	Fitim i pashpërndarë	Totali i kapitalit
Gjëndja më 1 janar 2017	3,216,205	3,907,675	7,123,880
Fitimi neto për periudhën kontabël		1,497,006	1,497,006
Gjëndja më 31 dhjetor 2017	3,216,205	5,404,681	8,620,886
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	6,267,249	6,267,249
Gjëndja më 31 dhjetor 2018	3,216,205	11,671,930	14,888,135

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BALFIN SH.P.K**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveç rasteve ku shprehet ndryshe)***PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE**

	Sh.	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fluksi parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		6,343,553	1,497,007
Rregullimet për:			
Te ardhurat nga dividendet		(5,862,752)	(1,651,704)
Amortizimi		15,107	9,874
Humbjet nga këmbimet valutore		172,520	55,703
Zhvlerësim i te arketueshmeve nga palet e lidhura		20,125	-
Fitime nga shitja e aktiveve afatgjate		(592)	(47)
Shpenzime/Te ardhura neto nga interesi		116,790	55,653
Rregullime te kapitalit te punes:			
(Rritje)/rënie kërkesat e arketueshme		29,371	(30,380)
(Rritje)/rënie në kërkesa te tjera te arketueshme		(51,981)	378,350
Rritje/rënie kërkesa te tjera te pagueshme		702,296	(1,983,212)
Pagese e tatim Fitimit		(76,304)	-
Paraja Neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		1,408,709	(1,668,757)
Fluksi i parave nga veprimtarite investuese			
Blerje e shoqerive te kontrolluara		(2,910,262)	(1,110,523)
Rritje kapitali ne pjesmarre ne shoqeri, neto		(817,036)	(1,084,835)
Blerje e shoqerive me pjesmarre JV		24,465	118,625
Blerje e shoqerive jo te kontrolluara		55,424	17,150
Ndryshimi ne Investime te tjera		141,913	(141,913)
Blerje Aktive afatgjate		(47,092)	(27,114)
Shitje e aktiveve afatgjate		3,836	176
Dividendët e arkëtuar		5,862,752	1,651,704
Hua te dhena		(2,611,749)	194,029
Paraja neto, e perdorur ne aktivitetet e investuese		(297,748)	(382,702)
Fluksi i parave nga veprimtarite e financiare			
Ndryshimi ne huamarrje		(2,362,164)	954,863
Huamarrje te reja		1,163,843	1,678,120
Ripagime te huave		(414,874)	(1,156,520)
Interesi i paguar		5,138	3,677
Interesi i arketuar		(121,928)	(59,330)
Para neto e perdorur ne aktivitetet financiare		(1,729,985)	1,420,810
Rritja/renia neto e mjeteve monetare nga aktiviteti		(619,025)	(630,649)
Efekt i kursit të këmbimit mbi mjetet monetare		(120,556)	(103,958)
Mjete monetare ne fillim te periudhes kontabel	11	2,366,136	3,100,743
Mjete monetare ne fund te periudhes kontabel	11	1,626,555	2,366,136

Pasqyra e fluksit te parase duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHESHME

Balfin sh.p.k. është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 25 Tetor 2007 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në regjistrin e shoqërive tregtare në të njejtën ditë, me kapital të nënshkruar prej 100,000 lekë. Më datë 08.04.2008 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, shoqëria ndryshon emrin e saj nga Samir Mane Consulting Group në Balfin Sh.p.k. Kapitali i shoqërisë më datë 31.12.2018 është 3,216,205,000 lekë. Administrator është Znj. Edlira Muka dhe aksioner i vetëm është Z. Samir Mane i cili zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë me vlerë nominale për një aksion 32,162,050 lekë.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat.

Objekti: Aktiviteti i shoqërisë është investimi dhe konsulenca.

Certifikimi tatimor: NIPT K72223031K

Forma juridike e shoqërisë: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Adresa e selisë: ABA Busines Center, Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2018 shoqëria kishte 88 punonjës (31 dhjetor 2017: 72 punonjës).

2. BAZAT E PËRGATITJES DHE DEKLARATËS SË PAJTUESHMËRISË**a. Bazat e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare të vecanta janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), të publikuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat financiare të vecanta në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”). Pasqyrat financiare të vecanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë pasqyrat e para, të cilat Shoqëria i ka përgatitur në përputhje me SNRF-të. SNRF 1 kërkon dhënie informacionesh shpjeguese të detajuara për efektin e tranzicionit nga SKK në SNRF, efekte të cilat janë përshkruar në Shënimin 5 në vijim të këtij raporti. Pasqyrat financiare të vecanta SNRF të Shoqërisë përmbajnë, pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e flukseve të parasë dhe shënimet e pasqyrave financiare.

Shoqëria ka përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 të audituara më 27 janar 2020, të cilat mund të gjenden në faqen zyrtare të Shoqërisë.

Më poshtë paraqiten parimet kryesore të politikave kontabël në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare janë shprehur në lekë dhe vlerat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt (‘000), përveçse kur është shprehur ndryshe.

b. Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike. Baza e matjes për çdo aktiv, detyrim, të ardhur dhe shpenzim është përshkruar në shënimet shpjeguese me detaje.

c. Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lek”, e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur 000’ në Lek.

d. Parimi i vijueshmërisë

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Drejtimi nuk është i vetëdijshëm për ndonjë pasiguri materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi Shoqërinë në periudhat e ardhshme. Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të parimit të vijueshmërisë, i cili supozon që shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë e saj operacionale për periudhën e ardhshme të parashikueshme.

3. PERDORIMI I VLERESIMEVE, SUPOZIMEVE DHE GJYKIMEVE

Në aplikimin e politikave kontabël të Shoqërisë, që përshkruhen në Shënimin 4 të këtyre pasqyrave financiare, drejtimit i kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto gjykime, vlerësime dhe supozime.

Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël do të njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar në qoftë se rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudhat e ardhshme në qoftë se rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe ato të ardhme.

Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve të rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë.

Tatimi mbi të ardhurat

Shoqëria është subjekt i tatimit të fitimit në Shqipëri. Gjykimi i rëndësishëm kërkohet për të përcaktuar vlerën e tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Ka shumë transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi nga legjislacioni është i pasigurt. Shoqëria njeh detyrimet për tatimin e parashikuar për çështje të auditimit bazuar në vlerësimet nëse do të ketë shtim në detyrimin tatimor. Kur rezultati përfundimtar i tatimit për këto çështje është ndryshe nga shumat e regjistruara fillimisht, diferencat do të ndikojnë në aktivin dhe detyrimin tatimor aktual dhe të shtyrë në periudhën kur bëhet përcaktimi.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon në mënyrë të vazhdueshme jetën e dobishme të aktiveve të mbajtura me kosto në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmërinë e pritur të këtyre aktiveve. Megjithatë, rezultatet reale mund të ndryshojnë për shkak të konsumimit teknologjik.

Zhvlerësimi i investimeve të kontrolluara dhe pjesëmarrjeve në kapital.

Shoqëria në cdo datë raportimi vlerëson nëse ka të dhëna për zhvlerësim të mundshëm të investimeve në shoqëri dhe sipërmarrje të përbashkëta duke konsideruar informacionin financiar prospektiv. Shoqëria vlerëson nëse fitimet e pritshme së bashku me levizjet e tjera në kapital e tejkalojnë ose jo koston e investimit, duke rregjistruar një zhvlerësim për rastet kur investimet priten të gjenerojnë humbje më të mëdha se kosto e investimit.

Shoqëria gjatë vitit 2019 nuk ka zhvlerësime të investimeve (2018: zero)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në pasqyrat financiare dhe janë zbatuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Regjistrimet kontabël të Shoqërisë janë paraqitur në monedhën vendase “Lek”, e cila është monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon Shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë tjetër nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë regjistrohen në monedhë të huaj dhe rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodhin.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**(a) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Transaksionet e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përkthyer me kursin e këmbimit të datës që ndodh transaksioni. Kurset e këmbimit të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare për monedhat kryesore (EUR, USD, GBP) më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si vijon:

Monedha	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/LEK	123.42	132.95
USD/LEK	107.82	111.10
GBP/LEK	137.42	149.95

(b) Instrumentat financiarë

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, paratë dhe ekuivalentët e tyre, llogari të pagushme tregtare dhe të tjera, te arkëtushme dhe te pagushme nga njesite ekonomike të grupit dhe kredi me interes e huadhenie të tjera.

Aktivët Financiarë*i. Njohja dhe matja fillestare*

Aktivët financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Përveç llogarive të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të rëndësishëm financimi ose për të cilat Shoqëria ka zbatuar lehtësimet praktike të standartit. Shoqëria mat një aktiv financiar me vlerën e drejtë të tij plus koston e transaksionit, kjo në rastin e një aktiviteti financiar të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ajo duhet të krijojë flukse të mjeteve monetare që janë 'vetëm pagesa e principalit dhe interesit (VPPI)' për shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim quhet test VPPI dhe kryhet në nivel instrumenti financiar.

Modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si menaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare. Shoqëria ka aktive financiare të arkëtueshme tregtare dhe kredi me interes e huadhenie të tjera nga të cilat pret vetëm arkëtimin e principalit dhe interesit në rast se aplikohet.

ii. Matja e mëpasshme

Sipas standartit për qëllime të matjes së mëpasshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktivët financiarë me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit);
- Aktivët financiarë me vlerë të drejtë përmes ardhurave gjithëpërfshirëse ("VDATGJ") me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit);
- Aktivët financiarë të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes ardhurave gjithëpërfshirëse ("VDATGJ") pa riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e çregjistrimit (instrumentat e kapitalit neto);
- Aktivët financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("VDNFH").

Shoqëria më 31 dhjetor 2018 ka vetëm aktive financiare me koston e amortizuar. Gjate vitit 2017 ajo ka pasur investime me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("VDNFH"), megjithatë tregtimi i instrumentave financiarë nuk ka qenë një aktivitet i rregullt i Shoqërisë.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(b) Instrumentat financiarë (vazhdim)

ii. Matja e mëposhme (vazhdim)

Aktivet financiare me koston e amortizuar

Shoqëria mat aktivet financiare me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar të japin rritje në data të përcaktuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

Aktivet financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (në qoftë se me kamatë) dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlersimit). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Aktivet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme, kredi me interes dhe huadhënie, dhe mjete monetare dhe të ngjashme.

Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("VDNFH")

Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes përfshijnë aktivet financiare të mbajtura për tregtim, aktivet financiare të përcaktuara me njohjen fillestare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose aktiveve financiare të kërkuara me detyrim të maten me vlerën e drejtë. Aktivet financiare klasifikohen si të mbajtura për tregtim nëse ato janë blerë me qëllimin e shitjes ose riblerjes në të ardhmen e afërt. Aktivet financiare me flukset e parave që nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit klasifikohen dhe maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, pavarësisht modelit të biznesit.

Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes mbarten në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë me ndryshime neto në vlerën e drejtë të njohura në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Kjo kategori përfshin instrumente kapitali të listuara në bursë të cilat Shoqëria i ka blerë me qëllimin e tregtimit dhe realizimit të fitimit nga shitja e blerja e ketyre instrumentave. Dividentët nga investimet e kapitalit të listuara njihen gjithashtu si të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur është vendosur e drejta e pagesës.

iii. Modifikimi i aktiveve financiare

Shoqëria shpesh modifikon kushtet e aktiveve financiare me palet e lidhura ku kur modifikimi i kushteve të aktivitetit financiar nuk është i konsiderueshem, sic është kohezgjatja, atehere ndryshimet e rimatjes njihen në fitim ose humbje. Kur keto modifikime janë të konsiderueshme atehere c'rrëgjistrojnë aktivin dhe një aktiv të ri.

iv. Çregjistrimi

Shoqëria çregjistrojnë një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivitetit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**(b) Instrumentat financiarë (vazhdim)***v. Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Shoqëria aplikon kërkesat e zhvlerësimit të IFRS 9 për gjithë instrumentat financiarë që mbahen me kosto të amortizuar. Për të arkëtueshmet tregtare dhe huadheniet, Shoqëria aplikon metodën e thjeshtëzuar, pra Shoqëria nuk ndjek ndryshimet në rrezikun e kredisë, por rregjistron një zhvlerësim për humbjen e pritshme të kredisë për të gjithë jetëgjatësinë e aktivitetit në çdo datë raportimi.

Për huadheniet ndaj filialeve të saj, përfshi garancitë e ofruara për kredite të marra nga ato filiale nga sistemi bankar, Shoqëria vlerëson humbjen e pritshme të kredisë në bazë të analizave individuale të flukseve të pritshme të kthimit të kredive dhe gjyqimit mbi ecurinë e biznesit të filialeve meqenese menaxhimi i Balfin është i përfshirë ngushtë në administrimin e kompanive që kontrollojnë apo që ka influencë në vendimarrjet e tyre.

Shoqëria merr parasysh supozimin e SNRF se një aktiv financiar konsiderohet i borxh i keq kur pagesat kontraktuale janë 90 ditë të më vonë.

Shoqëria mat humbjen e pritshme të kredisë (HPK) për gjatë gjithë jetës së aktivitetit si diferencën mes vlerës neto aktuale të gjitha pagesave të pritshme kontraktuale me ato të pritshme (duke marrë parasysh dhe vlerën e parasë në kohë).

Një aktiv financiar fshihet kur nuk ka pritshmeri të arsyeshme për rikuperimin e flukseve monetare kontraktuale.

Llogaritë të arkëtueshme dhe të tjera

Llogaritë të arkëtueshme dhe të tjera fillimisht shprehen me vlerë të drejte dhe maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

Huadhenie dhe kredi me interes

Llogaritë të arkëtueshme dhe të tjera fillimisht shprehen me vlerë të drejte dhe maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit (NEI). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktiviteti rregjistrohet, si dhe përmes procesit të amortizimit të NEI.

Investime në kapitale të listuara

Investimet në kapitale të listuara maten me vlerën e drejte ku çdo datë raportimi rishikohet në vlerën e tregtueshme në bursë të kapitaleve të zotëruara, ku ndryshimet në vlerën e drejte rregjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Ato nuk janë subjekt zhvlerësimi sepse risku kreditor është i reflektuar në cmimin e tregut.

Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj

Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj përfshijnë para në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare. Për qëllime të përgatitjes së pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentë të saj përfshijnë para dhe depozita afatshkurtra me maturitet deri në 3 muaj.

Detyrimet Financiare*i. Njohja fillestare dhe matja fillestare*

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kreditë dhe huamarrjet ose të pagueshme.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe të pagueshmeve, neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare, të tjera të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare të cilat janë të gjitha klasifikuar si të mbajtura me kosto të amortizuar.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(b) Instrumentat financiarë (vazhdim)

Detyrimet Financiare (vazhdim)

ii. Matjet e mëpasshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- me kosto të amortizuar.

Shoqëria nuk mban asnjë detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit (NEI). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur detyrimet çregjistrohen, si dhe përmes procesit të amortizimit të NEI.

iii. Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara. Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë cdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

Huatë nga Institucionet financiare

Huatë e marra nga institucionet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit që përgjithësisht është vlera kontraktuale e huase meqenese gjithë marreveshjet janë bere me kushte tregu. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë llogaritje për koston e amortizuar të një detyrimi financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Të tjera

Instrumenta të tjerë financiarë jo-derivativ vlerësohen me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga zhvlerësimi.

Kompensimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të shlyer shumat dhe ka për qellim ti shlyejë ato ne baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

(c) Investimet në filiale dhe sipërmarrje të përbashkëta

Pjesëmarrjet janë të gjitha ato njësi mbi të cilat Shoqëria ka një ndikim të rëndësishëm në politikat e saj financiare dhe të shfrytëzimit, por nuk i kontrollon ato. Ndikimi i rëndësishëm presupozohet se ekziston kur Shoqëria merr pjesë në vendimet e politikave financiare dhe operative dhe ato të investimeve por nuk i kontrollon ato.

Nje sipërmarrje e përbashket është nje marreveshje kontraktuale sipas te ciles dy apo me shume pale ndermarrin nje veprimtari ekonomike qe është subjekt i kontrollit te përbashket. Sipërmarrjet e

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**(c) Investimet në filiale dhe sipërmarrje të përbashkëta (vazhdim)**

perbashketa mund te marrin formen e aktiviteve te kontrolluara se bashku, te aktiveve te kontrolluara se bashku, ose te njesive te kontrolluara se bashku.

Shoqëria mat investimet ne pjesmarrje te perbashketa ose njesi jo të kontrolluara me kosto pakesuar me ndonje humbje nga zhvleresimi.

Shoqëria njeh shpërndarjet e marra nga investimi si të ardhura, pa marrë parasysh nëse shpërndarjet janë nga fitimet e njëjësive ekonomike të kontrolluar bashkërisht të akumuluar para ose pas datës së blerjes.

(d) Investimet në shoqëri te kontrolluara

Shoqëria ka përgatitur pasqyra financiare të vecanta sipas kerkesave ligjore ne shtetin e regjistrimit, ku ka zgjedhur prezantimin e investimeve në shoqëri të kontrolluara me kosto pakësuar me ndonje humbje nga zhvleresimi.

(e) Klasifikimi afatshkurter dhe afatgjate

Shoqëria i paraqet të drejtat dhe detyrimet në pasqyrat financiare bazuar ne klasifikimin afatshkurter dhe afatgjatë. Një aktiv konsiderohet afatshkurtër kur:

- Pritet te realizohet, shitet apo konsumohet në ciklin normal të funksionimit
- Mbahet kryesisht për shitje/tregtim
- Paraja e gatshme ose ekuivalenti i parave, përveç nëse kufizohet nga këmbimi ose përdoret për të shlyer një detyrim të paktën dymbëdhjetë muaj pas vitit raportues

Një detyrim është afatshkurtër kur:

- Pritet që të vendoset në ciklin normal të funksionimit
- Mbahet kryesisht për qëllime tregtie
- Do të zgjidhet brenda dymbëdhjetë muaj pas vitit raportues

ose

- Nuk ka asnjë të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë zgjidhjen e përgjegjësisë për të paktën dymbëdhjetë muaj pas vitit të raportimit.

Shoqëria i klasifikon të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera si afatgjata. Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra klasifikohen si aktive dhe detyrime afatgjata.

(f) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse të funksionalitetit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje.

Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve materiale përcaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitet dhe njihet neto në të ardhura ose humbje të tjera.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**(f) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***Kostot në vijim*

Kostot për zëvendësimin e një aktivi regjistrohen me vlerën kontabël të aktivit në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të, të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'regjistrohet.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivit ose cdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave bazuar në metodën e vlerës së mbetur sipas normave të mëposhtme për secilen kategori asetesh:

a) Makineri paisje	20%	c) Paisje informatike	25%
b) Mjete transporti	20%	d) Paisje zyre	20%

Zhvlerësimet e aktiveve jo financiare

Shoqëria nuk ka aktive jo-financiare të rendësishme. Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidencë e tillë për rënie në vlerë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim.

Një humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave.

(g) Përfitimet e punonjësve*Kontributet e sigurimeve shoqërore*

Gjatë ecursisë normale të biznesit, shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

Pensioni i detyrueshem

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve për të kontrivuar në planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostot që ndodhin për këto plane i takojnë Shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.

Leja e zakonshme e paguar

Shoqëria njih si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritët të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

(h) Provigjonet

Një provigjon njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parase për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen si aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë takse që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parase dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(i) Të ardhurat nga kontratat me klientët

Të ardhurat nga kontratat me klientet nuk aplikohet pasi të ardhurat kryesore të Shoqërisë janë nga kontratat e konsulencës të cilat të cilat janë të anulueshme në çdo moment pa penalitete të rendësishme dhe nuk i plotesojnë perkufizimet e SNRF 15.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**(j) Të ardhura nga shërbimet e konsulencës**

Konsistojnë në të ardhurat që kompania përfiton nga shërbimet mbështetese dhe këshilluese që ofron ndaj kompanive të grupit. Këto të ardhura njihen dhe merren në bazë mujore dhe janë kryesisht fikse, në përputhje me metodologjinë e faturimit të secilës shoqëri. Në varësi të nevojave të grupit, mund të ofrohen edhe shërbime të tjera që ndryshojnë nga muaji në muaj dhe alokohen sipas projekteve ose departamenteve përkatëse.

(k) Të ardhura nga interesat

Shoqëria jep hua për palët e lidhura ose për të tretët në varësi të nevojave financiare. Për huatë e dhëna aplikohen interesa fikse që i faturohen palëve referuar kontratave të nënshkruara. Këto të ardhura mund të jenë mujore (për sa kohë zgjat kontrata) ose mund të aplikohen në mbarim të afatit të huasë.

(l) Të ardhura nga dividendet

Shoqëria njeh të ardhura nga dividendi i shpërndarë nga shoqëritë e kontrolluara ose jo të kontrolluara në përputhje me vendimet dhe performancën financiare të shoqërisë për shpërndarje dividendi.

(m) Të ardhura nga qiratë

Shoqëria faturon palët e lidhura për qira për hapësirën e ambjenteve të zyrave. Të ardhurat nga qeraja janë të drejta që i lindin shoqërisë nga qeratat operative. Kostot fillestare direkte që ndodhin në momentin e negociimit të një kontrate qeraje operative, njihen si shpenzim gjatë kohëzgjatjes së qerasë, në të njëjtën mënyrë si të ardhurat nga qeraja. Kushtet lehtësuese të një marrëveshje qeraje janë të përcaktuara në termat e qerasë, dhe shpërndahen gjatë afatit të qerasë, edhe nëse pagesat nuk janë kryer mbi këtë bazë. Termat e qerasë janë të pa kthyeshme gjatë kohëzgjatjes së qerasë së bashku me cdo term tjetër, deri në momentin ku qeramarrësi ka opsionin për të vazhduar qeranë, dhe drejtuesit kanë siguri që qeramarrësi do ta ushtrojë këtë opsion.

(n) Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje, dhe nga rënia në vlerë e aktiveve financiare. Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

(o) Shpenzime për tatim fitimin

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital, në të cilat rregjistrohen direkt në kapital. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet si diferenca e përkohshme mes vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së tatueshme korresponduese përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm.

Detyrimet e tatimit të shtyrë në përgjithësi llogariten për të gjitha diferencat e tatueshme të përkohshme. Aktivitetet e tatimit të shtyrë në përgjithësi njihen për të gjitha diferencat e zbritshme të përkohshme në masën që ekziston mundësia që fitimi i tatueshëm do të jetë i mundshëm në mënyrë që këto diferenca të zbritshme të përkohshme të mund të përdoren. Këto aktive dhe detyrime të tatimit të shtyrë nuk do të njihen në qoftë se këto diferenca rezultojnë nga njohja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk prek as fitimin e tatueshëm, as fitimin kontabël.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**(o) Shpenzime për tatim fitimin (vazhdim)**

